



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.925/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Ferki Xhaferi kryesues Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Vullnet Luzhinca, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Suharekës, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Suharekës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet apeli Anr.925/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Vullnet Luzhinca, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Suharekës, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Suharekës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet vetëm për Kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Suharekë nga Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Suharekës, në Vendvotimet VV 2403A/01R, VV 2417A/01R, 2424A/02D dhe 2421A/01R në Komunën e Suharekës.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimit si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.925/2021 të paraqitur nga Vullnet Luzhinca, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Suharekës, nga Subjekti Politik AAK, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se në Vendvotimet VV 2403A/01R, VV 2417A/01R, 2424A/02D dhe 2421A/01R se nuk është respektuar vullneti i votuesve ashtu që është manipuluar me votat e tija. Në mbështetje të pretendimeve të tij apelit i ka bashkangjitur deklarat e katër votuesve të tij.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton Vullnet Luzhinca, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Suharekës, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Suharekës, brenda afatit ligjor, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në Venvotimet VV 2403A/01R, VV 2417A/01R, 2424A/02D dhe 2421A/01R, në komunën e Suharekës.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimeve si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, pasi që mbështetet edhe në prova të dorëzuara nga kandidati, si në deklarata dhe Formularin e Rezultateve për Kandidat, ku shihet se ka mospërputhje ashtu që edhe nga deklaratat e gjithsej katër votuesve të bashkangjitura në shkresat e lëndës me deklarin se në vendvotimet e lartëcekura kandidati në fjalë ka gjithsej 15 vota. Gjithsej vota nga të dhënat zyrtare të verifikuara për këto vendvotime kanë rezultuar të jenë 3 vota derisa nga deklaratat e dëshmitarëve ishte dashur të jenë 15 vota.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimim e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.925/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Xhafeti

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.